



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura IV
Komisioni për Buxhet dhe Financa
Mbledhja nr. 136/13
Prishtinë, më 12.12.2013, ora 14:00
Ndërtesa e Kuvendit, sala C-203

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR BUXHET DHE FINANCA

Në mbledhje morën pjesë: Safete Hadergjona, Naser Osmani, Latif Gashi, Hasime Krasniqi, Jelena Bontic, Hykmete Bajrami, Muhamet Mustafa, Xhevdet Neziraj, Duda Balje, Sevdije Lama dhe Albana Fetoshi.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Vilson Ukaj, Sabrije Saliuki – Iseini, Bashkim Kurtaj, Dashurije Canolli, Imba Rudaku (praktikante) dhe Arbëreshë Kosumi (praktikante).

Gjithashtu ishin të pranishëm: Besim Beqaj- Minister i Financave, Agim Krasniqi-Drejtor i Buxhetit, Blerand Kadriaj nga MF.

Mbledhjen e kryesoi: Safete Hadergjona, Kryetare e Komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i Raportit me Amendamente të Komisionit për Buxhet dhe Financa për Projektligjin për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2014;
3. Të ndryshme;

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari theksoj se vonesa e mbajtjes së mbledhjes ka ndikuar pozitivisht për shkak se stafi ka vërejtur disa lëshime që kanë ndodhur gjatë përgatitjes së raportit dhe të cilat janë plotësuar në draftin e ri të raportit që e keni përpara.

Rendi ditës u miratua pa ndryshime.

2. **Miratimi i Raportit me Amendamente të Komisionit për Buxhet dhe Financa për Projektligjin për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2014**

Kryetarja njoftojë anëtarët e komisionit me amendamentet që kanë ndryshime dhe ato që nuk kanë. Kryetarja theksoi Amendamentet 1-7 nuk kanë ndryshime.

Latif Gashi tek amendamenti 7 propozoj që sqarimi "Komisioni Funkcional ka përkrahur pjesërisht amendamentin e deputetit Hydajet Hyseni" të paraqitet tek pjesa nën A.

Propozimi i z. Gashi u përkrah njëzëri.

Kryetarja theksoj se nga Qeveria e Republikës së Kosovës ka propozuar një amendament në pjesë tekstuale të projektligjit. Në takimin e mbajtur të komisionit është diskutuar kërkesa lidhur me pjesën që ka të bëjë me bilancin bankar të Ligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës ku është kërkuar nga Qeveria që kjo të përshkruhet në pjesën tekstuale pasi që në bilancin bankar janë të përfshira mjetet nga Privatizimi i 75% të aksioneve të PTK-së. Amendamenti i propozuar nga qeveria kërkon që pas nenit 18 të shtohet një nen i ri dhe thotë: Mjetet në shumën prej 277 milion Euro nga shtija e 75% të aksioneve të PTK-së, përfshihen në bilancin bankar sipas Ligjit të Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2014. Këto mjete, siç përcaktohet me nenin 22.A.6, të Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, të plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-194, do të përdoren vetëm për investime kapitale. Me miratimin e Ligjit të Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2014, raporti i dorëzuar nga Qeveria me 27 maj 2013, nr.144/13 në Kuvendin e Republikës së Kosovës, konsiderohet i miratuar.

Besim Beqaj sqaroj se amendamenti është propozuar zyrtarisht nga Qeveria dhe duhet të përfshihet në tekstin e Ligjit të Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2014.

Naser Osmani vlerësoj se ky amendament është politikë e dikujt tjetër. Dua ta konstatoj amendamentin e Qeverisë me rregullore të Kuvendit Neni 57, pika 3 ku thuhet se Qeveria mundet të sjell amendament brenda dy javë pune. Dy javë tashmë kanë kaluar dhe Qeveria nuk ka të drejtë ligjore që të sjell amendament. Çdo futje e amendamentit në tekstin e aprovuar është shkelje e ligjit dhe rregullorës së Kuvendit.

Latif Gashi theksoj se kjo kërkesë e Qeverisë është diskutuar edhe më herët në Komision, konsideroj se nuk është jashtë afatit ligjor.

Muhamet Mustafa konstatoj se duhet të ndjeken procedurat e rregullta për vendimin e Kuvendit për privatizim dhe gjithë ajo që duhet të diskutohet nga LDK-ja është përqindja. Të thuhet se konsiderohet i aprovuar raporti i cili është duke u diskutuar që pesë muaj në Kuvend, është e papranueshme.

Hykmete Bajrami theksoj se shpesh thirrmi në praktikat e vendeve të zhvilluara, nuk besoj se në ndonjë vend të botës me votim të ligj të buxhetit të futet kinse kemi aprovuar edhe një raport që nuk është aprovuar për shkak të refuzimit të hyrjes në rend të ditës. Nëse Qeveria mendon t'i shantazhoj deputetët me ligj të buxhetit duhet t'a keni të ditur se do t'a rrezikoni buxhetin. Askush nuk e detyron Qeverinë ti shpenzoj parat e privatizimit për diçka tjetër pasi kjo mund të bëhet me një vendim të ndarë. Por pjesa tjetër me miratim të Ligjit të Buxhetit të konsiderohet edhe raporti të cilin deputetët nuk kanë pranuar për ta futur në rend të ditës, është e papranueshme dhe mënyra më e pahijshme, e pa kulturuar.

Latif Gashi konstatoj se sistemi organizativ është i tillë që ndonjëherë duhet të ketë mospajtime, propozoj që të vazhdojmë. Opozita ka të drejtë që ti mbroj qëndrimet e veta Kurse ne të pozitës mbrojmë politikat për të cilat jemi përcaktuar.

Albana Fetoshi vlerësoj se edhe për Grupin Parlamentar të Vetëvendosjes është e papranueshme kjo mënyrë e privatizimit të Postës, në këtë amendament e kemi diskutuar edhe më herët dhe shumica e deputetëve e kanë kundërshtuar. Raporti për Privatizimin e PTK-së nuk është votuar për t'u fut në rend të ditës në seancë, prandaj edhe kjo mënyrë sesi është propozuar nga qeveria kontrabandohet Privatizimi i PTK-së përmes ligjit të buxhetit. Mendoj se është i papranueshëm, i paarsyeshëm dhe jashtë çdo logjike, pra jam kundër këtij amendamenti.

Besim Beqaj sa për informim, kur është diskutuar edhe në takimin e komisionit, të martën më është sugjeruar nga Komisioni ta sjellim në mënyrës zyrtare propozimin prandaj amendamenti është regjistruar konform rregullave të cilat janë të paraparë.

Latif Gashi theksoj se për kërkesën e Qeverisë egzistojnë procesverbalet në KBF, është diskutuar brenda afatit dhe kemi rekomanduar që ta sjellin në formë të shkruar. Nuk është kontestuese afati kohor, e gjitha është çështje e vullnetit tonë se a e kalojmë apo jo këtë amendament. Sikurse të gjitha kërkesat tjera që i kemi shqyrtuar edhe këtë e kemi shqyrtuar brenda afatit duke pas qëndrime të përafërta me propozimin që e ka bërë ministri në takimin e mbajtur në Pejë.

Kryetarja theksoj se sipas Nenit 57, pika 3 të Rregullores së Kuvendit, thuhet se janë dy javë pune afat ky brenda të cilit mund të sillen amendament nga akterët e caktuar dhe mendojë që këtu nuk llogariten ditët e vikendit.

Pas diskutimeve dhe propozimit, Komisioni me shtatë vota Për (Safete Hadergjonaj, Latif Gashi, Jelena Bontic, Hasime Krasniqi, Duda Balje, Sevdije Lama dhe Xhevdet Neziraj) katër vota Kundër (Naser Osmani, Muhamet Mustafa, Hykmete Bajrami dhe Albana Fetoshi) dhe asnjë Abstenim përkrahu amendamentin e propozuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës, për shtimin e një neni të ri pas nenit 18 në pjesën teksutale të Projektligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2014.

Kryetarja sa i përket amendamenteve në pjesë tabelare, nga ato ndryshime që ka vërejtur stafi për dallim nga raporti që e keni pranuar si anëtar të komisionit dje, është një ndryshim i propozuar Ministria e Financa, që në amendamenti në 18 pika 1, në vend të Bankës Botërore të shkruhet Qeveria Austriake. Ndryshimi u përkrah njëzëri. Kryetarja po ashtu njoftoj se amendamenti 43 nuk është votuar që ka të bëjë me shkurtime buxhetore për të akomoduar ndarjet e reja buxhetore.

Besim Beqaj sqaroj se në kuadër të diskutimeve, i kemi propozuar Komisionit që të mos ketë shkurtime buxhetore, pasi të gjitha ndarjet do të merren nga rezervat.

Hykmete Bajrami pyet ministrin se a janë bërë të gjitha shkurtime nga rezervat pasi që më herët na është thënë se rezerva është kategori që me ligj duhet të jetë si e tillë. Kur është kontestuar 7.5 mil që kanë qenë shpenzime kapitale të paparashikuara drejtori i buxhetit ka sqaruar se ajo është rezervë që Qeveria duhet ta ketë me ligj dhe e kemi shpërndarë, dhe si mundet që tani të shkurtohet? Pasi që ne kemi insistuar që të shkurtohen investimet e paspecifikuara përkatësisht shtresimi i rrugëve.

Agim Krasniqi sqaron se Kuvendi dhe KBF do të ketë vendime dhe kërkesë e KBF ka qenë që të lihet një pozicion në mënyrë që vendimet të përkrahen, pra është rritur Rezerva nga 4 mil në 10.5 mil, rezervat e paparashikuara mbesin më shumë sesa që kanë qenë në vitin e kaluar. Pjesa tjetër është e rregulluar me një nen tjetër tek Ministria e Infrastrukturës.

Amendamenti 43 u miratua me një votë Kundër (Albana Fetoshi) dhe të tjerët Për.

Kryetarja njoftoi se edhe amendamenti 44 nuk është votuar dhe është një propozim standard që bëhet për të mundësuar harmonizimin e tabelave të buxhetit si rezultat i ndryshimeve që ka rekomanduar Komisioni, pasi që një ndryshim në një tabelë të buxhetit, reflekton edhe në tabelat tjera.

Amendamenti 44 u miratua njëzëri.

Kryetarja sa i përket amendamentit 47 Grupi Parlamentar Koalicioni për Kosovë të Re ka tërhequr amendamentin dhe ka sjell një amendament të ri duke zvogëluar shumën nga 8 mil € në 150.000 € për zgjerimin e rrugës nacionale M25.2 Segmenti Udhëkryqi për rrugën e vjetër të Gjilan-Graçanicë.

Amendamenti 47 i propozuar Grupi Parlamentar Koalicioni për Kosovë për shtimin e projektit të ri “Zgjerimi i rrugës nacionale M25.2 Segmenti Udhëkryqi për rrugën e vjetër të Gjilanit –Graçanicë” në shumë prej 150,000€, u miratua njëzëri.

Kryetarja njoftoj se ka ardhur një kërkesë nga Komuna e Istogut për asfaltimin e rrugës regjionale, projekt i cili kushton 4.140.000 €.

Besim Beqaj propozoj që nga bashkëfinancimi me komunat të ndahen edhe 1 mil € për përkrahjen e kërkesës së komunës së Istogut.

Miratohet kërkesa për shtimin e projektit të ri në buxhetin e Ministrisë së Infrastrukturës “Asfaltimi i rrugës regjionale R 221- Istog”, në shumë prej 1,000,000 €,

Xhevdet Neziraj kam kërkesë për një projekt të ri: Asfaltimi i rrugës në fshatin Gllogjan - lagjja Mustafaj-Qerimaj”- komuna Deçan në shumë prej 70,000 €.

Miratohet kërkesa për shtimin e një projekti të ri në buxhetin e komunës së Deçanit: Asfaltimi i rrugës në fshatin Gllogjan - lagjja Mustafaj-Qerimaj”, në shumë prej 70,000 €.

Hykmete Bajrami vlerësoj se është shumë e nevojshme asfaltimin e rrugës Kliçinë-Budisalc pasi që i lidhë disa fshatra me tokat e tyre bujqësore. Vlera e kësaj rruge kushton 600.000 €, propozoj që të hapet si kod buxhetor dhe të ndahet çfarëdo shume.

Miratohet kërkesa që në shtohet projekti i ri në buxhetin e Komunës së Pejës “Ndërtimi i rrugës Kliçinë-Budisalc” në shumë prej 100,000 €.

Hasime Krasniqi propozoj që edhe në emër të deputetëve tjerë sidomos ata që vijnë nga rajoni i fshatrave Drenas, Skenderaj, Komoran poashtu komunave që janë përreth tyre, një kërkesë zgjerimin dhe asfaltimin e rrugës prej 23 km me vlerë prej 25 mil €. Kërkoj nga Ministri që ta përkrah këtë propozim.

Besim Beqaj duke vlerësuar rëndësinë e kësaj kërkesë dhe duke ditur kompleksin memorial që ekziston në atë pjesë, propozoj që të hiqen 15 mil nga Rruga 6 dhe 3 mil nga Ministria e Infrastrukturës dhe ti ndahen 18 milion € për kërkesën e propozuar nga deputetja Krasniqi.

Latif Gashi vlerësoj se Prekazi është vend i shenjtë dhe Kryeministri duke dashur të jetë modest ka investuar në autostradë, rrugë magjistrale dhe vende të tjera duke e lënë atë pjesë. Është një kërkesë shumë e arsyeshme që mendojë se duhet përkrahur.

Komisioni me dy vota Kundër (Hykmete Bajrami dhe Albana Fetoshi) dhe shtatë vota Për (Safete Hadergjona, Jelena Bontic, Latif Gashi, Hasime Kransiqi, Duda Balje, Sevdije Lama dhe Xhevdet Neziraj) miratoj kërkesën shtimin e projektit të ri në buxhetin e Ministrisë së Infrastrukturës “Zgjerimi i rrugës Komoran-Drenas-Skenderaj” në shumë prej 18,000,000€”.

Hykmete Bajrami insistoi që të sillen amendamentet edhe një herë në votim.

Kryetarja kërkoj te projektet që kanë dal për komunitetin turk dhe boshnjak, përkatësisht në takimin e mbajtur në Pejë që të dy projekteve ti ndahen nga 150.000 €.

Komisioni miratojë kërkesën që në komunën e Prizrenit, në pikën 2 projekt i ri “Qendra kulturore Turke në Prizren”, shuma të ndryshohet në 150, 000 €.

Albana Fetoshi theksoj se nuk është në rregull që në këtë formë deputetët të sjellin amendamente dhe të shantazhojnë me votat e qytetarëve.

Komisioni njëzëri miratoj amendamentet e Projektligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2014.

Mbledhja përfundoi: 14:40.

Përgatitur nga:

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryetarja e Komisionit

Safete Hadergjona